



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**KOMISIONI I PAVARUR**  
**për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.115/2016**  
**“Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”**

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në mbledhjen e datës 28/01/2019, miraton me 5 vota pro dhe asnjë kundër, Raportin si më poshtë:

**R A P O R T**

**MBI**  
**MASAT E NEVOJSHME DHE DISA REKOMANDIME**  
**NE LIDHJE ME SITUATEN E KRIJUAR PAS VENDIMIT NR. 12 DATE 22.01.2019**  
**TE AUTORITETIT PER INFORMIM MBI DOKUMENTET E**  
**ISH-SIGURIMIT TE SHTETIT**

**BAZA LIGJORE:**

- Nenet 288, i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- Vendimi i Kuvendit nr.74/2018 “Për ngritjen e Komisionit të Pavaruar për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”.

**ANALIZA MBËSHTETET NË :**

- Nenin 149/b Neni 149/c i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- Nenet 105, pika 2, dh), 108 pika 3, d) dhe 279 i Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” (Përbërja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe mandati i anëtarëve Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” pika 7 (që i referohet ngritjes së KLP për herë të parë);
- Vendimin nr. 12 datë 22.1.2019, të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit.

Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me shkresë të Prokurorisë së

Përgjithshme, në datë 25 janar 2019, u vu në dijeni të Vendimit nr. 12 datë 22.1.2019, të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, i cili referon se (citim):

- a) Zoti Bujar SHESHI, në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 29, pika 2, germa c, të ligjit nr.45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” figuron në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit si bashkëpunëtor, Sektori V, drejtimi Inteligjencë-Rini, por nga verifikimet e deri tanishme nuk disponojmë dokumente që vërtetojnë aktivitetin e tij;
- b) Zoti Bujar SHESHI, sipas nenit 29, pika 2, germa c, të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, figuron të ketë materiale në emër të tij në dokumjente të ish-Sigurimit të Shtetit, si anëtar me detyrë Hetues në Sektorin e Hetuesisë së Degës së Punëve të Brendshme të Fierit që nga viti 1979.

Komisioni i Pavarur, konstaton se Prokuroria e Përgjithshme, ka përcjellë tek Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, formularin për verifikimin e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Zotit Bujar Sheshi, që në datë 26.10.2018.

Kërkesa është futur për shqyrtim dhe është trajtuar në mbledhjen Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në datë 31.10.2018.

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, i ka përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile “kërkesën për informim”, në datë 10.01.2019.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes civile, ka kthyer përgjigje në datë 16.01.2019, dhe pas administrimit të përgjigjes dhe shqyrtimit të të gjitha të dhënave që disponon, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ka marrë vendimin e sipërcituar të datës 22.01.2019 që i është përcjelle prokurorisë së Përgjithshme në datë 23.01.2019.

Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve dhe zgjedhja e kandidaturave për anëtarë të KLP, është bërë në datë 11.12.2018.

Nga krahasimi i të gjitha referencave kohore të listuara më sipër, Komisioni i Pavarur, konstaton se:

- ka një diferencë të konsiderueshme në kohë nga dita e marrjes së kërkesës për verifikim nga Prokuroria e Përgjithshme dhe shqyrtimi i saj në mbledhjen e parë të Autoritetit për Informim, deri në ditën që Autoriteti për Informim, i ka përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, kërkesën për verifikim të rregjistrimit të shtetasve;
- kërkesa për verifikim të rregjistrimit të shtetasve i është përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, një muaj pasi Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve është kryer dhe nga votimi ka dalë edhe miratimi i kandidaturës së Zotit Bujar Sheshi.

Komisioni i Pavarur, shqyrtoi dispozitat Kushtetuese dhe ato ligjore, për procedurat, kushtet dhe kriteret për përzgjedhjen në detyrën e anëtarit të KLP si dhe rastet e vakancave në KLP.

Neni 149/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon midis të tjerave që:

1. Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbaron kur, (d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit”;

2. Mbarimi i mandatit deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kur vendi i anëtarit mbetet vakant, organi që ka emëruar anëtarin paraardhës, sipas nenit 149, emëron një anëtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të larguar.

4. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, me përjashtim (midis të tjerave), të rastit të parashikuara në nënparagrafin “d” të cituar më sipër.

Në vlerësim të Komisionit të Pavarur nisur nga Vendimi i Autoritetit për Informim, vlerësohet si në kushte të pazgjedhshmërisë në ushtrimin e funksionit dhe kandidatët për KLP, qenia anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991 (në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”).

Neni 101 Ligji 115/2016 (Përbërja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe mandati i anëtarëve) parashikon:

1. Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorisë.
2. Anëtarët prokurorë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve të të gjitha niveleve.

Përbërja dhe mandatet, referuar procesverbalit të Mbledhjes së Parë dhe afati i mandateve të dala nga shorti janë si më poshtë:

1. Genti Ibrahim	- 3 vjet	
2. Alfred Balla	- 5 vjet	
3. Nurihan Seiti	- 5 vjet	
4. Sander Beci	- 3 vjet	
5. Tartar Bazaj	- 5 vjet	
6. Arben Dollapaj	- 3 vjet	- prokuror
7. Bujar Sheshi	- 5 vjet	- prokuror
8. Antoneta Sevdari	- 3 vjet	- prokuror
9. Besnik Cani	- 5 vjet	- prokuror
10. Gentjan Osmanaj	- 5 vjet	- prokuror
11. Kostaq Beluri	- 3 vjet	- prokuror

**Në vlerësim të sa më sipër dhe nisur edhe nga sensibiliteti i çështjes,  
Komisioni i Pavarur**

**I REKOMANDON:**

- Komisionit të Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, të ushtrojë kompetencat e parashikuara nga neni 36 i Rregullores së Kuvendit, duke thirrur në seancë të posaçme, anëtarët e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për të kërkuar:
  - o shpjegime dhe analizë të plotë, arsyet dhe shkaqet e vonesës në shqyrtim dhe verifikim të rastit;
  - o raport të plotë për afatet e shqyrtimit dhe kthimit të përgjigjeve, për të gjitha kërkesat e marra nga Autoriteti për verifikimin e kandidaturash në zbatim të dispozitave të ligjit;

- raportim të detajuar, për raste të tjera kur Autoriteti megjithë kapërcimin e të gjitha afateve, nuk i ka kthyer ende përgjigje institucionit kërkues, në veçanti kur kërkesa është në funksion të ngritjes së organeve të reja të qeverisjes së drejtësisë, (si në rastin e Zotit Sheshi).
- Këshillit të Lartë të Prokurorisë, mbledhjen e menjëhershme për shqyrtimin e rastit, vlerësimin dhe vendimmarrjen, në kushtet e dispozitave të Kushtetutës dhe Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” dhe
- Prokurorisë së Përgjithshme të referojë masat e marra, menjëherë pas marrjes dijeni të vendimit të Autoritetit për Informim.

Ky Raport i përcillet:

- Komisionit të Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut;
- Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe
- Prokurorisë së Përgjithshme.

ARTAN SPAHIU

**KRYETAR**

PETRIT PLOÇI

**ANËTAR**



SAIMIR VISHAJ

**ANËTAR**



IRENA NINO

**ANËTAR**



LINDITA RUSMALI

**ANËTAR**

